



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr.4652/1 prot.

Tiranë, më 08.05.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Adresa postare: Rr. “Abdi Toptani”, Nd. 5, Tiranë
Nr. Tel: 00355 42237200

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e tyre, protokolluar në ISSH me nr. 4652 prot., datë 17.04.2024, ju informojmë se:

Bazuar në nenin 7, të Ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore si një institucion publik ka përcaktuar listën e dokumenteve ekzistuese, që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, të cilën e ka bërë publike në faqen zyrtare të ISSH, www.issh.gov.al, në rubrikën “Dokumentat e Hapura”.

Rubrika “Dokumentat e Hapura” përmban:

Statistika të përgjithshme;

Statistikat e vitit korent;

Legjislacioni;

Rregullore;

Marrëveshje ndërinstitutionale;

Marrëveshje ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore, shoqëruar me ligjet përkatëse.

Çdo qytetar gëzon të drejtën të përdorë ose ripërdori pa pagesë dokumentat e mësipërme, për qëllime fitimi ose jo, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Personi i kontaktit, i cili do të raportojë në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurin këtij procesi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është znj. Xhoana Koxhaj, Kordinatore për të drejtën e informimit, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ju falenderoj për mirëkuptimin!